REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 1002/20
Datë/Datum. 12.01.21
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr.1002/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të: Goran Milenković - Kryetar, Nuhi Paçarizi - Referues, Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik "FEHMI RAQI B.I N.T.P "EURO-COMMERCE"-Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik: "GHM Company", lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me llamarinë gypa dhe bulona, LOT-1 Furnizim me gypa rrethor dhe katror të çelikut", iniciuar nga AK – KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a , më datën: 11.01.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. **APROVOHET**, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik "FEHMI RAQI B.I N.T.P "EURO-COMMERCE" - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me llamarinë gypa dhe bulona, LOT-1 Furnizim me gypa rrethor dhe katror të çelikut", iniciuar nga AK – KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.

II. **ANULOHET**, njoftimit për dhënie të kontratës lidhur aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me llamarinë gypa dhe bulona, LOT-1 Furnizim me gypa rrethor dhe katror të çelikut", iniciuar nga AK – KORPORATA ENERGJETIKE E OSOVES sh.a. dhe lënda kthehet ne **Rivlerësim.**

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik "FEHMI RAQI B.I N.T.P "EURO-COMMERCE" – Prishtinë, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatori ekonomik "FEHMI RAQI B.I N.T.P "EURO-COMMERCE" - Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 24.11.2020 me nr. 1002/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me llamarinë gypa dhe bulona, LOT-1 Furnizim me gypa rrethor dhe katror të çelikut", iniciuar nga AK – KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 6, 7, 28, 59, 60 dhe 69 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 26.11.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 04.12.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:
Pas shqyrtimit në detaje të lëndës së tenderit lidhur me këtë aktivitet të prokurimit dhe duke u bazuar në dokumentacionin në dispozicion, eksperti shqyrtues jep këtë mendim si në vijim:

Sa i përket pretendimit të AK-së se Certifikata ISO Standard 9001:2015 e dorëzuar nga OE ankues nuk është në përputhje me kërkesat e paraqitura në FDT dhe nuk përkon me fushëveprimin e tenderit në fjalë, Eksperti Shqyrtues pas shqyrtimit të dokumentacionit të tenderit, analizës dhe hulumtimit të pavarur e gjen pretendimin e AK-së si të pabazuar. Arsyetimi vijon si më tutje:

- Kërkesa e Autoritetit Kontraktues është që "Certifikata ISO (**Certifikimi i prodhuesit** sipas ISO 9001 2015)". Do të thotë, AK ka kërkuar që Certifikata ISO e specifikuar me fushëveprim të lartpërmendur **të merret nga prodhuesi**, pavarësisht që ISO standardi i lartpërmendur specifikon kërkesat e përgjithshme për një sistem të menaxhimit të cilësisë të një organizate. Do të thotë, edhe pse të gjitha kërkesat si parakushte të standardit ISO 9001: 2015 janë gjenerike dhe synojnë të zbatohen për çdo organizatë, pavarësisht nga lloji ose madhësia e saj, ose produktet dhe shërbimet që ofron, kërkesë e Autoritetit Kontraktues ka qenë që certifikata e një standardi të tillë të ketë fushëveprimin e kompanisë prodhuese (eng: manufacturing). Si sqarim shtesë, "scope" e certifikatës është dashur të përkojë me prodhimtarinë (eng: manufacturing) e produkteve për të cilat është iniciuar ky aktivitet i prokurimit, gjegjësisht Lot 1. Si e tillë, Autoriteti Kontraktues ka vlerësuar tenderin konform nenit 41.3 ku thuhet që "Vetëm kërkesat dhe kritere e dhënies së kontratës të specifikuara në njoftim për kontratë/dosje të tenderit mund të përdorën si bazë për vlerësim".

Duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartpërmendura dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, kronologjinë e rastit në fjalë dhe natyrën e pretendimeve, Eksperti shqyrtues dhe ai teknik e shohin ankesën e operatorit ekonomik ankues si të pabazuar, duke sugjeruar kështu që njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me llamarinë gypa dhe bulona, LOT-1 Furnizim me gypa rrethor dhe katror të çelikut" me nr. të prokurimit: "KEK-20-3036-1-1-1", *aktivitet ky i iniciuar nga AK:* KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a, të mbetet në fuqi. Një sugjerim i tillë vjen si rezultat i konstatimeve të pretendimeve ankimore me fushëveprim teknik dhe administrativ.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues duhet të jetë: e pabazuar dhe vendimi i AK-së të mbetet në fuqi.

Autoriteti Kontraktues, nuk ka përgjigje

Operatori Ekonomik me datë 07.12.2020, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 11.01.2021, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të

prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Sa i përket pretendimit të OE ankues "FEHMI RAQI B.I N.T.P "EURO-COMMERCE" – Prishtinë, se AK nuk e ka pranuar certifikatën ISO Standard 9001:2015 e dorëzuar nga OE ankues, ku AK e ka eliminuar se nuk është në përputhje me kërkesat e paraqitura në FDT dhe nuk përkon me fushëveprimin e tenderit në fjalë, Paneli Shqyrtues konform ekspertit/teknik shqyrtues pas shqyrtimit të dokumentacionit të tenderit, analizës dhe hulumtimit të pavarur e gjen pretendimin e OE-së si pjesërisht te bazuar. Arsyetimi vijon si më tutje:
Kërkesa e Autoritetit Kontraktues është që "Certifikata ISO (Certifikimi i prodhuesit sipas ISO 9001 2015)". Do të thotë, AK ka kërkuar që Certifikata ISO e specifikuar me fushëveprim të lartpërmendur të merret nga prodhuesi, pavarësisht që ISO standardi i lartpërmendur specifikon kërkesat e përgjithshme për një sistem të menaxhimit të cilësisë të një organizate. Do të thotë, edhe pse të gjitha kërkesat si parakushte të standardit ISO 9001: 2015 janë gjenerike dhe synojnë të zbatohen për çdo organizatë, pavarësisht nga lloji ose madhësia e saj, ose produktet dhe shërbimet që ofron, kërkesë e Autoritetit Kontraktues ka qenë që certifikata e një standardi të tillë të ketë fushëveprimin e kompanisë prodhuese (eng: manufacturing). Si sqarim shtesë, "scope" e certifikatës është dashur të përkojë me prodhimtarinë (eng: manufacturing) e produkteve për të cilat është iniciuar ky aktivitet i prokurimit, gjegjësisht Lot 1. Autoriteti Kontraktues nuk ka kërkuar sqarime shtese lidhur me këtë Certifikate nga OE ankues.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Prandaj obligohet autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit të ofertave dhe në të ardhmen ti përmbahet në detaje të gjitha dispozitave të LPP-së dhe kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues sqaron se autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Gjithashtu paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesues i Paneli Shqyrtues

Goran Milenković

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK "KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES" sh.a;

1x1 OE "FEHMI RAQI B.I N.T.P "EURO-COMMERCE" –Prishtinë;

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.